



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RREGULLORE

PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT

NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË

“MASTER I ARTEVE DHE MESUESI”

NË FAKULTETIN E ARTIT SKENIK,

NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026

MIRATUAR ME VENDIM NR 10, DATË 07/02/2024
TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE





Arsimit të Lartë, në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 76, “Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve”, si dhe mbështetur në Rregulloren e UART të ciklit të dytë të studimeve, konkurset e pranimit në Fakultetin e Artit Skenik për vitin akademik 2022-2023 do të zhvillohen si më poshtë:

Neni 1 **Pranimi i kandidatëve**

- 1.1 Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Artit Skenik në Universitetin e Arteve, bëhet me konkurs mbi bazën e rezultateve të konkurseve që zhvillohen për studimet në ciklin e dytë të studimeve “Master i Arteve” pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj rregulloreje si dhe kritereve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 1.2 Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta “Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja”, do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3 Përzgjedhja e tyre është e ndërruar nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit Sportit, posaçërisht për trojet Shqiptare.
- 1.4 Kandidatë për program të dytë studimi.

Neni 2 **Kriteret e pranimit**

- 2.1 Pranimi në programet e ciklit të dytë MASTER I ARTEVE DHE MESUESI është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe zotërojnë diplomën BACHELOR.
- 2.2 Kandidatët mund të kenë kryer programin e studimit të ciklit të parë Bachelor pranë këtij fakulteti ose në Fakultete të tjera si brenda dhe jashtë vendit.
- 2.3 Pranohen të gjithë ata kandidatë që kanë kryer studimet në ciklin 4-vjeçar në fakultetin e Artit Skenik. Gjithashtu edhe ato kandidatë të ciklit 4-vjeçar, të fakulteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- 2.4 Nota mesatare e kandidatëve preferohet të jetë mbi 7 (e ponderuar)
- 2.5 Për konkurrentët që kanë kryer studime jashtë vendit duhet bërë paraprakisht njehsimi i Diplomës në strukturat përkatëse të MAS.
- 2.6 Baza e konkurrimit për kandidatët në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Artit Skenik për studime në ciklin e dytë të studimeve “Master i Arteve dhe Mësuesi”, janë kriteret e miratuara nga departamentet përkatëse si dhe nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 2.7 Konkurrimi për këtë cikël studimesh ka në bazë **dy faza**:
Faza e parë: *shqyrtimi i dosjes së kandidatit.*
Faza e dytë: *bashkëbisedim me kandidatët.*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- 2.8 Kandidatët për programin e studimit "Master i Arteve dhe mësuesi", për vlerësimin e Fazës së parë duhet të dorëzojnë pranë Fakultetit të Artit Skenik, dosjen personale të konkurrentit ku të jenë të përfshira:
- I. CV e tij/e saj,
 - II. Diploma Bachelor ose e sistemit 4 vjeçar,
 - III. Lista origjinale e notave të programit të studimit të kryer,
 - IV. Dëshmi mbi rezultatet e arritura në procesin e realizimit të programit mësimor,
 - V. Projekte,
 - VI. Shfaqje,
 - VII. Filma,
 - VIII. Ekspozita, etj.
- 2.9 Dosja duhet të përmbajë dëshmitë e aktiviteteve artistike, si brenda dhe jashtë shkollës:
- I. Postera,
 - II. Fletë palosje,
 - III. Fotografi,
 - IV. Dhe çdo material tjetër që dëshmon aktivitetet artistike të konkurrentit.
- 2.10 Kandidatët që kanë kryer programe të tjera studimi, jashtë Fakultetit të Artit Skenik, brenda dhe jashtë vendit do të kenë dhe një intervistë me komisionin e pranimit.
- 2.11 Për çdo sqarim tjetër në lidhje me konkursin, programet e studimit si dhe me plotësimin e krediteve, drejtohuni pranë Fakultetit të Artit Skenik.

Neni 3

Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 3.1 Dekani i Fakultetit, mbështetur në propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimit për çdo program e Studimi.
- 3.2 Përbërja e Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 3.3 Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
- I. Titullarë të fushës përkatëse,
 - II. Pedagogë efektivë të Departamenteve përkatëse,
 - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi ku nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij neni.
- 3.4 Në përbërjen të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit apo janë në konflikt interesi.
- 3.5 Në ambientet ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Artit Skenik .
- 3.6 Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurrimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posaçëm ngre grupin përkatës, i cili monitoron cilësinë e zhvillimit të gjithë procedurave të konkurrimit në Fakultetin e Artit Skenik. Po ashtu konkursi monitorohet dhe nga përfaqësuesit e MAS.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 4
Procedura e konkurrimit.

- 4.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e Nenit 2, të kësaj rregulloreje.
- 4.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët që janë regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Artit Skenik, brenda afatit të përcaktuar nga MASR.
- 4.3 Konkursi për Fakultetin e Artit Skenik do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit, sipas udhëzimeve të MASR.
- 4.4 Komisionet e pranimit do të marrin në shqyrtim vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurrim nga sekretaria mësimore.
- 4.5 Në momentin e rregjistrimit kandidati duhet të paraqesë:
 - I. *Kartë Identiteti,*
 - II. *Pasaportë për jashtë shteti.*
 - III. *Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.*
- 4.6 Kandidati konkurrent për të hyrë në konkurs duhet të ketë bërë pagesën e përcaktuar, në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- 4.7 Në varësi të numrit të kandidatëve për secilin Program Studimi komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite. Oraret bëhen të ditura më parë dhe shpallen në ambientet e Fakultetit .
- 4.8 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe ambientet e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik.
- 4.9 Sekretaria mësimore ju dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, dosjet përkatëse si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 4.10 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet kur e shohin të nevojshme krijojnë tërë hapësirën kohore të nevojshme për shpërfaqjen individuale të kandidatëve.

Neni 5
Mënyra e Vlerësimit

- 5.1 Vlerësimi maksimal për çdo konkurrent është gjithsej **100 pikë**.
- 5.2 Vlerësimi maksimal i Fazës së I të konkurrimit :
 - Nota mesatare e ponderuar **30 pikë**
 - Shqyrtimi i dosjes personale **30 pikë**
- 5.3 Vlerësimi maksimal i Fazës së dytë të konkurrimit bashkëbisedim me kandidatët është **40 pikë**.
- 5.4 Pikët minimale që duhet të marrë një konkurent për t'u pranuar si fitues në ciklin e dytë të studimeve Master, **janë 40 (dyzetë) pikë**.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 6

Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 6.1 Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhet nga Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga titullari i Fakultetit.
- 6.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).
- 6.3 Gjatë shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu çdo anëtar i jurisë gjatë fazës së bashkëbisedimit ka të drejtë t'i drejtojë kandidatin që konkurren pyetje konkrete, të cilat i duken të arsyeshme për një shpërfaqje sa më të mirë të tij.
- 6.4 Në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurrimit, Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, mblidhet për të vlerësuar një për një paraqitjet e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 6.5 Pikët maksimale për vlerësim janë 100.
- 6.6 Pikët minimale që kandidati të shpallet fitues janë 40 pikë.
- 6.7 Secili anëtar i komisionit të pranimit vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatin.
- 6.8 Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 6.9 Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit.
- 6.10 Komisionet e Pranimit të Programit të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet dhe kasetat me materialet e mësipërme ja dorëzojnë me procesverbal në sekretarinë e Fakultetit.
- 6.11 Lista përfundimtare me pikët respektive për të gjithë Programet e Studimit firmosen nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit Sportit.

Neni 7

Shpallja e fituesve

- 7.1 Shpalljen përfundimtare për fituesit e bën Dekani i Fakultetit mbi bazën e kuotave të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 7.2 Në rastin kur disa konkurren kanë fituar të njëjtin numër pikësh, ata renditen midis tyre duke marrë si bazë notën mesatare të ponderuar.

Neni 8

Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 8.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.





- 8.2 Kandidatët që regjistrohen si student në Universitetin e Arteve duhet të paraqesin **dokumente origjinale.**
- 8.3 Ato duhet të jenë:
- I. Diploma Bachelor
 - II. Për kandidatët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dokumentet e mësipërme duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe e të noteruara.
 - III. Kartë identiteti,
 - IV. Pasaportë,
 - V. 2 (dy) fotografi
 - VI. Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit që caktohet nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
- 8.4 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 8.5 Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç'regjistrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.
- 8.6 Kandidatit që ç'regjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 8.7 Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Artit Skenik, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë.

Neni 9 **Rregulla për kandidatët**

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 9.1 Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve i shpallur në Fakultetin e Artit Skenik.
- 9.2 Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimi të Programit të Studimit në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni i Programit të Studimit. Mosparaqitja në bazë të këtij orari çon në s'kualifikimin e tij nga konkursi.
- 9.3 Nuk lejohet përdorimi i celularëve.
- 9.4 Komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shpreh aftësitë e tij.
- 9.5 Kandidati do të largohet nga konkurrimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI
Prof. Gazmend GJOKA

DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI, KOREOGRAFI
Prof.asoc.Taulant PUSTINA

DEPARTAMENTI REGJI, REGJI FILMI DHE TELEVISIONI
Prof.asoc. Alert ÇELOALIAJ

DEKANI

Prof. Ilir MARTINI

